

MIGENA BALLA

**VËSHTRIM ETNOLINGUISTIK I HAPËSIRËS KRAHINORE
NË VEPRËN E PETRO MARKOS**

(“Retë dhe gurët”, “Një emër në katër rrugë”)

Mama Millja dikur i tregonte: “*Thonë se gurët e mëdhenj atje poshtë në Shënmëri, janë burrat që janë kthyer dhe kanë vdekur në vend... Kurse ata burra që kanë ikur dhe kanë vdekur në kurbet janë bërë re...*” Por “*Ai tani është një gur në vendin e tij. U kthye. Për ta parë tanimë të njohurin horizont nga fshati i vet.*”¹

Në rrugëtimin e jetës së tij ai shkeli, pa, jetoj e përjetoj copëza të botës së madhe, por çdo horizont i përflakur i sillte ndërmend vendlindjen e tij. Në çdo fjalë, rresht, në çdo vepër fshati i tij, krahina, njerëzit e tij janë të pranishëm aty për ta bërë ligjërimin më konkret.

Në veprën “Retë dhe gurët” që ai e quan më të rëndësishmen e krijimtarisë së tij dhe në romanin “Një emër në katër rrugë”, herë nëpërmjet intervistës me vetveten e herë nëpërmjet historisë së jetës të të tjerëve, jep të dhëna të hollësishme për vendlindjen, për njerëzit, vendet, zakonet, traditat, marrëdhëniet shoqërore, familjare etj.

Onomastika e përdorur në përshkrimin e krahinës së tij vjen shumë e pasur me elementë të antroponimisë, patronimisë, toponimisë (oikonimet) etj.

Brenda toponimisë një grup të madh përbëjnë oikonimet apo emrat e vendeve të banuara (fshatrave, krahinave, lagjeve): *Himara, Dhërmiu, Dhrimadhe, Vunoi, Piluri, Kallarati, Dukat, Llogora, Velçë, Mesaplik; Paloshpita, Qendusha, Spile, Konaku i Gjinit, Rahinë, Tabori, Rovole, Alevra, Kolgjoni, Kontavë, Hiellardha, Pangalladhe, lagja e Gjilolit, lagja e Gjinglekut* etj.; etnonimet (shtete, kombe, krahina): *Shqipëri, Greqi, Labëri, Kurvelesh, Lumi i Vlorës* etj. dhe një toponimi fetare karakteristike: *Shënapremte, Shën Theodhori, Shën Jani, Shëmitri, Shën Mëria, xhamia e Kallaratis, shën Spiridoni, Shën Thanasi* etj.

Me një vështrim të shpejtuar mbi cilëndo nga fushat e toponimisë, do të shohim se, nga Veriu në Jug të Shqipërisë shquan kudo një mendësi e përbashkët në vënien e emrave të viseve.² Në toponiminë e veprës së Markos dallohet tipi më i dendur apo mbizotërues në mikrotoponiminë shqiptare, ai me **përshkrim mbi bazën e një tofjalëshi të përbërë nga emri që tregon veçorinë topografike + emër të rasës gjinore që tregon përkatësinë apo ndonjë rrethanë historike-shoqërore me vlerë përcaktuese**³: *Konaku i Gjinit, shpella e Pano Gjinit, lëmi i Papa Trekos, pllaja e Pandelemonit, ullinjë e Shkurtajve, përroi i Stavridhit, vreshtat e Kocanajve, fari i Othonuzit, ulliri i Muços, Guri i piratit, etj.* Pra,

¹ Shih parathënien dhe shënimin në kopertinën e pasme të romanit “Retë dhe gurët”.

² Gj. Shkurtaj, *Onomastikë dhe etnolingistikë*, Tiranë, 2001, f. 55.

³ Po aty, f. 55.

bashkë me emrin e vendit janë fiksuar edhe emrat e personave të ndryshëm që kanë qenë protagonistë apo, pronarë a zotërues të atyre vendeve.

Disa emërtime lagjesh (oikonime) vijnë nga patronimet: ... nga të tre vëllezërit u shtuan lagjet *Lizaj, Çaçëdhimitrët dhe Trekot; një lagje e Dhërmiut quhej Gjinleku, lagjja e Gjilolit* etj.

Spikat, gjithashtu, dhe antroponimia e pasur në këtë vepër që sjell një varg emrash të njerëzve të afërt të Petro Markos apo dhe të bashkëfshatarëve të tij si: *mama Mille, Jani Marko, Zoicë, Pano Marko, Fotina, Andrea, Evanthia, Spiro Milo, Marko Jani, Jani Kuçuli, Foto Kuçuli, Barba Leka, mama Tulla, Kosta, Eftalia, Mantho Bua, Thanas Beno, Hamit Selmani, Bezhani, Mimi, Thoma dhe Naqe Konomi, Gaqe Kapora, Pavllo Vreto, Gjikë Nina, Gjikë Mërtiri, Gjikë Argjiri, Gjikë Bua, Mitro Bali, xha Foti, Kolë Dedja, zoti Kosta, Nikolla Qendusha, Janulla, Rizo, Sokrati, Pilo, Pano Bixhili, Gjikë Bixhili, Dhimo Katera, Mimi Mëhilli, Milto Gjonika, Thanas Lopsi, Dhimitër Leka* etj.; patronimet (emrat familjarë): *Martinajt e Gjilekut, familja Mëhilli ose Maruli, Markajt, Gjonët, Tavaj, Buajt, Lizaj, Çaçëdhimitrët, Trekot* etj.

Duke iu referuar studimit të patronimisë së Himarës nga profesor Rami Memushaj, do të dallonim në këtë grup patronime nga emra personash historikë të botës iliro-arbëreshe⁴, ku hyn emri *Leka* (emri shqiptar i Aleksandrit të Madh); patronime prej emrash shqiptarë, pjesa më e madhe e të cilëve nuk përdoren më si emra vetjakë⁵, si: *Beno, Bixhili, Nina, Treko, Vreto* etj.; patronime që rrjedhin prej emrash kristianë të botës romako-bizantine⁶: *Çaçi (Anastas), Gjoni (Joannes), Mërtiri (Martin), Pano (Panajot)* etj.; patronime që janë emra gjithashtu të botës së krishterë bizantino-greke⁷: *Andrea, Konomi, Martini* etj. patronime nga emra të përveçëm vetjakë të huaj⁸, numrin më të madh të të cilave e përbëjnë ato me prejardhje greke: *Foto, Marko* etj.

Një vajtje-ardhje të pandërprerë ka edhe nga emrat vetjakë (antroponimet) tek emrat familjarë (patronimet)⁹. Që në traditën e hershme shqiptare (ashtu si edhe në mënyrë universale) emri vetjak i atit ka shërbyer si emër familjar. Kjo traditë ka gjalluar dhe në historinë e origjinës së vetë Petro Markos i cili tregon: "...rrjedh nga familja e Gjin Bue Shpatës. Atij i lindën dy djem: Markoja dhe Gjoni, të cilët i bënë shtëpitë pranë e pranë. Aty në atë vend, Markajt dhe Gjonët bënë shtëpi të tjera se u shtuan..."¹⁰ "Im atë quhej Marko... Im atë ishte i biri i Jani Markos."

Duke i parë nga pikëpamja e strukturës, dallojmë qartë se, edhe në patronimet e përdorura në veprën e Petro Markos (patronime që i përkasin fshatit të Dhërmiut), ashtu si dhe në fshatrat e Himarës, emërtimet dygjymtyrëshe të tipit

⁴ R. Memushaj, *Patronimia e Himarës*, në Himara në shekuj, Tiranë, 2004, f. 299.

⁵ Po aty.

⁶ Po aty.

⁷ Po aty, f. 301.

⁸ Po aty.

⁹ Gj. Shkurtaj, *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, Tiranë, 2001, f. 15.

¹⁰ P. Marko, *Retë dhe gurët*, Tiranë, 2000, f. 13.

Vështrim etnolinguistik i hapësirës krahinore në veprën e Petro Markos

*A+B, ku A është emri i përveçëm vetjak dhe B emri i babait ose i gjyshit, përbëjnë modelin më prodhues*¹¹.

Por, nëse do të bënim një paralelizëm me antroponiminë e “Lahutës së Malësisë” të studiuar nga profesor Gjovalin Shkurtaj¹², do të vinim re se **mendësia malësore** apo **tradita e Malësisë së Madhe, po edhe më gjerë**, për t’iu drejtuar burrave me emër dhe mbiemër (patronim), del shumë qartë edhe në veprën e Petro Markos: *Jani Marko, Foto Kuculi, Mantho Bua, Gaqe Kapora, Pavllo Vreto, Pano Bixhili, Thanas Lopsi, Hamit Selmani, Gjike Argjiri, Gjike Nina* etj.

Një fushë ku gjuhësorja dhe shoqërorja pleksen me mundësi përkimi e përfaqje interesante është ajo e emrave të njerëzve, e zbulimeve apo trajtave të dyta përkëdhelëse me shkurtime ...për lidhjet e marrëdhëniet e farefisnisë, përgjithësisht të lidhjeve familjare, martesore, gjinore etj.¹³ Në këtë vepër gjejmë përdorime të zbulimeve apo të trajtave të dyta përkëdhelëse për të mënjauar emrin e gjatë: *Mimin (Dhimitrin), Leli (ashu i thoshim Vangjel Bixhilit, një kushëritim tim...¹⁴) mama Millja (në i thoshim mama Mille. Shumë vonë, kur u bëra burrë, mësova se ajo emrin e kishte Fotina¹⁵)* etj.

Fjalët zbuluese, si shprehje e etnografisë së të folurit, na dalin edhe si respektforma në disa raste: **mama Millja** ishte gjyshja e Petro Markos, por kështu e thërrisnin edhe fëmijët e tjerë, jo vetëm nipërit e saj; **mama Tulla**, ashtu e thërrisnin gruan e xhaxhait; **barba Leka** ishte daja i vogël; **xha Foti** ishte daja i madh; **xha Mantho Bua**, ai që ishte në krye të kuvendit familjar; nga ato anë, gjyshit i thonë **zot** etj.

Shpesh, njerëzve u mbeten edhe emra të dytë apo nofka nga më të çuditshmet, një pjesë e të cilave e kanë burimin tek format e dyta zbuluese apo përkëdhelëse, si ato që kemi përmendur, por ka edhe mjaft sosh që nuk kanë asnjë afër lidhjeje, as me emrin e parë, as me ndonjë rrethanë zbuluese. Disa nofka vendosen edhe për të tipizuar karakterin e personit ose mënyrën e tij të jetesës; një nga personazhet e veprës së Markos mbahej si kusar pulash për këtë ai thirrej me nofkën Kostë Kunadhja, *vdiq Kostë Kunadhja! (Ai kishte humbur mbiemrin e familjes, fshatarët i kishin vënë një tjetër mbiemër: Kunadhja. Me kohë ai njihej prej të gjithëve si Kostë Kunadhja)*¹⁶; një tjetër që i rropi fshatarët duke i marrë para borxh e duke

¹¹ R. Memushaj, *Patronimia e Himarës*, në Himara në shekuj, Tiranë, 2004, f. 298.

¹² “Këtu në radhë të parë, më duket është me interes të përmendim një anë shumë të rëndësishme të mendësisë malësore, e cila më qartë se kudo del në veprën e Fishtës. E kemi fjalën për traditën e Malësisë së madhe, po edhe më gjerë, për t’iu drejtuar burrave me emër dhe mbiemër (patronim). Qysh në moshë të njomë, si për t’u nxitur shpirtin burrëror dhe etjen për mëvetësi e personalitet, malësorët e thërrasin njëri-tjetrin me emër e mbiemër, qoftë edhe kur rrinë së bashku ditë për ditë. Madje, jo rrallë, kjo vihet re edhe në mjedisin familjar apo miqësor intim.” cituar nga Gj. Shkurtaj, *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, Tiranë, 2001, f. 189.

¹³ Gj. Shkurtaj, *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, Tiranë, 2001, f. 144.

¹⁴ P. Marko, *Retë dhe gurët*, Tiranë, 2000, f. 307.

¹⁵ Po aty, f. 15.

¹⁶ P. Marko, *Një emër në katër rrugë*, Tiranë, 2001, f. 138.

mos ia kthyer thërritej me nofkën Pavllo Kusari, *Po Pavllo Kusari? Ai quhej Pavllo Mesari, po i mbeti Pavllo Kusari*, etj. Disa prej këtyre nofkave mbeten edhe si mbiemra (patronime) që shoqërojnë pasardhësit në breza.

Shprehja e respektit, apo siç quhet në terminologjinë përkatëse etnolinguistike “kortezia linguistike” ka ekzistuar në çdo vend dhe në çdo gjuhë, sepse ajo ka qenë dhe mbetet shprehje e traditave kulturore dhe lidhet ngushtë me organizimin politik e shoqëror dhe me zakonet e traditat e çdo vendi a kombi¹⁷. Në të dyja veprat e qëmtuara, përdoret respektforma **kapedan** e cila shërben si fjalë respekti për personat që kanë ushtruar profesionin e detarit, madje për detarët e regjur: *Thonë se djalli nuk kishte dalë, se kishte pasur frikë nga kapedan Gjika; Mbreti i Napoli, duke dëgjuar për kapedan Kumin...; kapedan Argjiri, ç`mendon kështu?... etj.* Gjejmë edhe raste kur respekti ndaj një personi shprehet me fjalë që mbartin në vetvete një lloj statusi shoqëror a familjar që dikton domosdoshmërisht një marrëdhënie respekti e vlerësimi: *humba edhe vjehrrën time, Shazijen, të cilën e thërrisja Zonjë. Ishte zonjë e vërtetë jo vetëm nga prejardhja, po edhe nga karakteri dhe mençuria*¹⁸, *zoti Kosta, zoti Naqe* etj.

Elementët etno dhe sociolinguistikë të cilët nxjerrin në pah marrëdhëniet midis familjeve a fiseve vijnë të gërshetuar me të dhënat patronimike: “...Markajt, Gjonët, Buajt ishin një **bark**, një **fis** dhe gjer vonë, sa isha unë i ri, nuk martoheshin me njëri-tjetrin. Kishin të drejtën e gjakut për njëri-tjetrin, quheshin **familje**”¹⁹. Familjet ishin të organizuara në **kuvendin familjar** i cili drejtohej nga më të vjetrit: “Kur rronte Xha Mantho Bua, meqë ishte më i moçmi, ne, si Markaj, Buaj e Gjonë, nuk mund të bënim asnjë veprim (martesë, krushqi, shitblerje tokash e të tjera) pa qenë ai në krye të kuvendit familjar. Kur vdiq ai vendin e tij e zuri Petro Gjoni.”²⁰ Fshati drejtohej nga **Kuvendi i pleqësisë**: “**kuvendi i pleqësisë** u mblodh lart në Shën Mëri.” “...çdo problem krahinor zgjidhej nga **pleqësia** e krahinës. Edhe problemet e vështira të fshatit a të familjeve të veçanta i zgjidhte **pleqësia**.” fshati u mërzi. Ç`t`i bëntë! **Pleqësia**, siç është tani Gjikë Nina, e thirri të shoqen...; Nasi dhe Tasi kthyen kokën dhe panë që kishin hyrë pleqtë e dhimojerondisë, domethënë ata që pleqësojnë çdo çështje dhe pastaj e zbatojnë.”²¹

Etnografia e të folurit në raste mortore na ofron gjithashtu elemente gjuhësore që lidhen me zakonet e traditat e vendlindjes së Markos: **mënyra e vajtimit**; *i vajtimit dhe i ligjërimin me vargje, ligjërimi me vargje, qante dy orë ditën me ligje, gratë ulërinin, çirrinin faqet dhe e qanin të ziun; gratë qanin me ligje, kurse burrat u binin gjokseve; e varrosi me kuje, vuri kujën, ligjërimi i motrës, me ligje prekëse, vajtonte bukur; varrosja: nuk e varrosëm aty ku ishin varrosur Andrea dhe Markoja (se ishte femër), por rrëzë Kambanerisë së madhe; zakonet pas vdekjes: zakoni ishte që burrat të shkonin disa mbrëmje me radhë te vatra ku*

¹⁷ Gj. Shkurtaç, *Emografia e të folurit të shqipës*, Tiranë, 2004, f. 80.

¹⁸ Po aty, f. 541.

¹⁹ Po aty.

²⁰ Po aty, f. 15.

²¹ P. Marko, *Një emër në katër rrugë*, Tiranë, 2001, f. 138.

Vështrim etnolinguistik i hapësirës krahinore në veprën e Petro Markos

dëgjohej kuja, ata burra që vinin darkë për darkë për ta ngushëlluar e për t'i lehtësuar dhimbjen; ashtu ishte; kur hynte njeri, binte heshtja për disa çaste; ajo nuk doli për vizitë në asnjë familje, as për lindje, as për martesë, as për vdekje, shkonte çdo të diel në kishë; ndjesë pastë, do të shkonte të rënkonte motrën e saj për vdekjen e burrit etj.

Në veprën e Markos gjenden gjithandej të dhëna për përkatësinë ortodokse të vendlindjes së tij. Përveç toponimisë tipike fetare që e kemi përmendur edhe më lart ka edhe shumë elemente të tjera që i përkasin ligjëritimit fetar, traditës dhe zakoneve të këtij besimi. ...**bëri kryqin** e mbarimit të drekës; ...*erdhën dy priftërinj në mes të natës. Më kënduan fqelon për të shpëtuar nga shkelja e djajve; duke bërë kryqin tri herë; deshi që t'ia bekonte papa Nikolla papa Nikolla... nisi të psallte disa tropare, ndërsa Argjiri bënte kryqin në heshtje; Gjikitë ishin të paktë, ngaqë nuk kishin ditë shenjtori për mesha e të kremte, dhe priftërinjve nuk u pëlqente që djemtë të pagëzoheshin me emra që s'kanë shenjtor; si ai i biblës në Jeriko, është në prehrin e Perëndisë, e kishte lexuar me shumë se prifti ungjillin etj.*

Interesante na paraqiten edhe disa zakone që rrjedhin nga tradita fetare ortodokse: Nëse dy të rinj i përkisnin një familjeje (një fisi), ... *prifti i fshatit nuk u vinte kurorë, se ishin të një gjaku. Prandaj ata shkuan në Korfuz dhe paguan dhespotin për t'i kurorëzuar...*²²; Vendosija e emrit të fëmijës (djalit) të familjes, *Zoti ka si detyrë që, pas tri ditësh të lindjes së mashkullit në familje, të shkojë tek i porsalinduri dhe me një hanxhar ose shpatë të qëllojë tri herë në krye të djepit duke thënë: "T'u ndiftë emri, more bir!"*²³ etj.

Në përshtatje me rrethanat e komunikimit, gjykimet, vlerësimet dhe mendimet popullore jepen në mënyrë të tërthortë, nëpërmjet frazeologjish e shprehjesh të shkurtra që kanë në themel thënie të moçme ose ndonjë anekdotë. Me nëntekste të mprehta apo me anën e "meseleve" a "rrotullave", të folurit bëhet i figurshëm... Ky karakter artistik ka natyrë popullore dhe shkon krahas e në përputhje të plotë me forcën e shpirtin krijues të popullit tonë, dëshmon gjallërinë, gjerësinë dhe larminë e fjalëve, të kuptimeve dhe të frazeologjizmave e mënyrave të të thënit me ngjyresa figurative në shqipen²⁴: *Gjikë Mërtiri, i cili tha: - Hodha grepin nga qielli / dhe nuk kapa as zogj, as re e as yje /po kapa bishtin e botës së lutjeve / drejtuar Perëndisë nga ata që vajtën. / Dhe qesha siç do të qeshin të nesërmit me mua!*²⁵ (Gjika donte të thoshte që ishte e vështirë kjo botë për njerëzit që donin të vendosnin drejtësinë); ...*le të turbullohet uji e të shohim se ç' do të bëhet!*²⁶ (Le të

²² P. Marko, *Retë dhe gurët*, Tiranë, 2000, f. 14.

²³ P. Marko, *Një emër në katër rrugë*, Tiranë, 2001, f. 7. Ky zakon përmendet nga Petro Marko edhe tek vepra "Retë dhe gurët" në f. 97.

²⁴ Gj. Shkurtaj, *Etnografi e të folurit të shqipes*, Tiranë, 2004, f. 106. Të folurit me "rrotulla" a "kunja" e kemi përmendur edhe në artikullin "Elemente të etnografisë së të folurit vlonjaçe në veprën e Ali Asllanit (Hanko Halla)".

²⁵ P. Marko, *Një emër në katër rrugë*, Tiranë, 2001, f. 7.

²⁶ Po aty, f. 28.

vijë lufta pa e shohim kush fiton) *Dinaku Kostë e kuptoi dhe iu përgjigj:- Qahen të vejat, pa qahen dhe nuset!*²⁷ (Qahen të varfërit, qahen edhe të pasurit.) *Çuditej me vete Mërtiri: "Sa shpejt u fut në kallëp ky!"*²⁸ (U bë njeri i rregullt); *Mërtiri u zu ngushtë. I kishte thënë mirë një herë babai: "Kur kapërcen një lumë, kujton se shpëtove! Po pak më tutje një lumë tjetër të del... Ashtu është jeta, gjersa njeriu është gjallë. Kapërcen lumenj të mëdhenj e të vegjël, dhe ai që di të notojë mirë, i kapërcen më lehtë..."*²⁹ etj. Bregasve, miq ndër shekuj me dukatasit e pjesë e Labërisë, nuk mund t'ju mungonte aftësia për të folur "me kunja" a me nënkuptime.

Gjinia si ndryshor etnolinguistik është shumë i qartë në çdo bashkësi gjuhësore. Gruaja dhe burri, edhe pse anëtarë të së njëjtës bashkësi shoqërore kanë dallime të dukshme në disa aspekte gjuhësore që burojnë nga marrëdhëniet që vetë shoqëria i ofron këtij binomi. Shpesh këto marrëdhënie burrë-grua lidhen ngushtë me natyrën konservatore ose liberale të një shoqërie të caktuar. Edhe në botën dhërmiasë të Petro Markos rolet e burrit dhe të gruas janë dukshëm të paracaktuara. Kur flet për mama Millen, ai rrëfëhet se "...Ka kohë që mendoj të bëj një roman për fatin e gruas sonë para Çlirimit, sidomos të gruas himarjote, duke e pasur atë si protagonist, se ka një jetë gjithë brenga, po kurdoherë kolonë, vitore e shtëpisë dhe e rezistencës ndaj dallgëve të ashpra të jetës sonë."³⁰ Një ndikim të dukshëm në dallimin leksematik e frazeologjik të grave nga burrat e bashkësisë gjuhësore përkatëse përbën edhe ndarja shoqërore e punës: *Burrat aty punën e mbarojnë paradreke. Ngrihen shumë herët, shkojnë e krasitin ose ngrenë ledhë, ose presin qiparisa për qereste...ose peshkojnë me dinamit, pra punë burrash; kurse gratë kanë punë të tjera: bëjnë dru, bëjnë punët e shtëpisë, po ato kurrë nuk therrin kecin dhe as që e rrjepin, gratë nuk shkojnë kurrë në pazar...*³¹

Një dallim të dukshëm me bazë gjinie (seksi) kemi edhe në mënyrën e vajtimit e të varrosjes: *gratë qanin me ligje, kurse burrat u binin gjokseve; Në dhomën tjetër dëgjohej vajtimi i grave... Dhoma e madhe ishte plot me burra; nuk e varrosëm aty ku ishin varrosur Andrea dhe Markoja (se ishte femër) etj.*

Në traditën e vjetër shqiptare ka qenë tabu dhe e ndaluar që gruaja t'i fliste në emër burrit (edhe anasjelltas) sepse, siç thoshte dhe Hanko Halla, "...femra kurrë s'mund t'i flasë në emër burrit që ka burrë...": *zuri të thërriste: "O Lolo more! (Nuk i thërriste në emër, po në emër të djalit, Lolo.)*

Përsëndetjet dhe urimet, tashmë si një pikë referimi me rëndësi e antropolinguistikës, edhe në gjuhën shqipe, ashtu si në çdo gjuhë tjetër, kanë pasur e vijnë të kenë rëndësinë dhe vlerat e veta, madje, në disa mjedise ruajtëse të skajeve të trojeve shqiptare, qoftë në Veri, qoftë në Jug, përsëndetjet janë shumë të larmishme dhe të lidhura ngushtë me veprimtaritë bujqësore, blegtorale, me

²⁷ Po aty, f. 96.

²⁸ Po aty, f. 106.

²⁹ Po aty, f. 256.

³⁰ P. Marko, *Retë dhe gurët*, Tiranë, 2000, f. 25.

³¹ P. Marko, *Një emër në katër rrugë*, Tiranë, 2001, f. 245.

Vështrim etnolinguistik i hapësirës krahinore në veprën e Petro Markos

praktikat e ndryshme e me jetën shpirtërore, porse ato, mjerisht, nuk janë përfillur sa duhet si lëndë etnolinguistike...³². Me një formë shumë interesante dhe shumë origjinale përshëndetjeje fillon dhe romani “Një emër në katër rrugë”:

Kaloje nga ndonjë monopat, shikoje ndonjë burrë që ngrinte ledhe për t`i mbushur pastaj me dhe, dhe e pyesje:

- Ç`po bën aty?- Dhe ai të përgjigjej:

- Ja, luftoj!

Shihje ndonjë grua që bënte dru në pllaja të pjerrëta, gërxhore...dhe e pyesje:

- Ç`po bën aty?- Dhe ajo të përgjigjej:

- Ja, luftoj!

Shikoje në pragun e dyerve të oborreve plaka të heshtura që turrnin duke shikuar detin, detin që u kishte marrë burrin ose djalin, dhe i pyesje:

- Ç`po bëni aty?- Dhe ato të përgjigjeshin:

- Ja, luftojmë!

Përgjigjja kuptimplote “Ja, luftoj!” pas asaj përshëndetjeje që rëndomthi e përdorim të gjithë, në çdo moment të ditës “Ç`bën?” është ajo që godet shumë fort dhe që ai e quan refrenin e jetës e të vuajtjeve të bashkëfshatarëve të tij në Dhrimadhe. Nëpërmjet këtij elementi etnolinguistik, Petro Marko na jep të qartë panoramën e jetës së vështirë në vendlindjen e tij.

Shpesh, mënyra sesi artikulohej përshëndetjet dhe gjestikulacioni me të cilën shoqërohen, tregojnë qartë marrëdhëniet midis personave që përshëndeten: *As zoti Kosta dhe as zoti Pandeli nuk lëvizën qafën. I hodhën nga një shikim të ftohtë dhe i kthyen përshëndetjen me fjalët e zakonshme: “Eja, zoti Rizo!”; ...pasi i përshëndeti ata pleq dhe ata burra që e nderuan pa lëvizur as qafën...; Dhe kur i përshëndeti dhe u largua ca metra, dëgjoi një zë:- Të fala plakës!- Pa dhe kjo u kthye dhe thirri me zë burri: - Të fala paçi... dhe ju u jepni të fala pleqve tuaj!...*

Në studimin e prof. Eqrem Çabejt “Disa aspekte të kulturës popullore shqiptare në vështrimin gjuhësor” theksohet se, “në radhë të parë, meritojnë vëmendje fjalët dhe frazeologjizmat nga lëmi i kulturës materiale e njëkohësisht shpirtërore, pikësëpari trinomi: **banim, ushqim, veshje**.”³³ Tiparet karakteristike të kulturës popullore që shfaqen në veprën e Petro Markos tipizojnë mënyrën e jetesës në atë krahinë : *shtëpitë kolibe, kamarullë, mësallë, vatra, qereste, servise, shtrojë, qilari, musëndra, sënduku, karsellë, katoi, shtëpitë e bardha si elemente të banimit; rronin duke punuar tokat, duke rritur bagëtitë, duke shitur valanidhe, tregtia e qitrove, tregtia e kafshëve, ngrinte ledhe, bënte dru, turrnin, canin gurë, rrëminin tokën, mblihdnin agrilidhe, shartonin nerënxa, shkundnin ullinj, kullotje manaresh, etj si mënyra jetese; fasule me vaj e limon, ullinj, qepë dhe tepse-misri të ngrohtë, kulaç, lakra, peshk, babanace si elemente të ushqimit; pantallona prej ndrilloje, qylaf i zi, poture, tirqe, caruqe me hundë etj., si elemente të veshjes.*

Të gjithë këta elemente etnolinguistikë plotësojnë “tablion” e panoramës së vendlindjes së Petro Markos me njerëzit, vendet, zakonet e traditat e na kujton se:

³² Gj. Shkurtaç, *Emograj e të folurit të shqipes*, Tiranë, 2004, f. 113.

³³ J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 2003, f. 65.

MIGENA BALLA

“Dhe fshati aty ishte. Dielli kishte rënë në ishuj, deti i gjerë çelte një horizont kujtimesh dhe mbresash të çuditshme.”

Dhe Petro Marko do të jetë gjithmonë aty me veprën e tij-det të gjerë që çel horizonte studimesh dhe lë mbresa vlerash të jashtëzakonshme.